



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 599/3 Prot.

Tiranë, më 07 / 05 / 2021

V E N D I M

Nr. 77, Datë 07 / 05 / 2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 73 Regj., datë 22.04.2021, të E. Z¹, kundër: Ambasadës Franceze në Tiranë dhe shoqërisë “ICTS Albania Integrated Services” sh.p.k, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjinisë²” dhe “ankimit për diskriminim në formën e shqetësimit ndaj Ambasadës Franceze në Tiranë³”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi⁴,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar pranë KMD-së nga subjekti ankues, rezulton se:

E. Z ka punuar pranë Ambasadës Franceze/Tiranë (Ambasada) që nga data 12.05.2014 me punëdhënësin Rogat Security. Më pas me datë 14.03.2016 ka nënshkruar kontratën individuale të punës me punëdhënësin “ICTS Albania Integrated Services” sh.p.k (ICTS), shoqëri kjo e kontraktuar nga Ambasada. Ankuesja ka punuar pranë Ambasadës në detyrën e Shefes së Ekipit

¹ Plotësuar nga ankuesja me datë 29.04.2021.

² Referuar procesverbalit të mbajtur me ankuesen, me datë 29.04.2021, në Zyrën e KMD-së.

³ Referuar tek “çdo shkak tjetër”, sipas listës së shkaqeve të LMD-së.

⁴ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

të Sigurisë dhe njëkohësisht Asistente e Shefit të Sigurisë në Ambasadë, deri me datë 01.01.2021, datë kur iu ndërpre kontrata e punës nga ana e punëdhënësit.

Ankuesja është shprehur se: *“Për vite me radhë puna ka vijuar më së miri, deri në momentin kur fillova të kisha shqetësime, kërcënime dhe diskriminim nga eprori i drejtëpërdrejtë në Ambasadë, z. TH. G, nëpunës i Ambasadës, Shef i Sigurisë, i cili, gjatë një zënke në datë 1 nëntor 2018 më kërcënoi hapur se nuk do të largohej nga Shqipëria pa më pushuar nga puna. Hakmarrja e tij u finalizua duke më dëbuar nga Ambasada më datë 29 shtator 2020, pas përfundimit të shërbimit tim në orën 18:10, pa asnjë njoftim apo lajmërim paraprak nga ana e punëdhënësit. Në procesverbalin e largimit nga Ambasada, punëdhënësi më njoftonte se nga ai moment e kisha të ndaluar aksesin në Ambasadë dhe se të nesërmen mund të filloja punë tek SGS Automotive Albania Fushë Prezë (SGS). Pas disa viteve punë shembullore pa asnjë vërejtje, përkundrazi me letra vlerësimi nga stafi i mëparshëm i Ambasadës (duke përfshirë edhe Zv/Ambasadoren), punëdhënësi u bë bashkë me Klientin (Shefin e Sigurisë së Ambasadës) duke mbështetur motive jo vetëm të pavërteta por dhe denigruese të imazhit dhe dinjitetit tim, në mënyrë që të siguronte kontratën edhe për vitin 2021. Sikur të mos mjaftonte ky diskriminim, punëdhënësi pavarësisht kërkesës time, në asnjë moment nuk më mbështeti, madje nuk u përpoq të mbronte dinjitetin tim, por lejoi të çenohej privatësia ime duke aprovuar shqyerjen e dollapit të sendeve të mia personale në dhomën e zhveshjes në Ambasadë, sende të cilat u kontrolluan një për një dhe u paketuan nga të tjerë, sikur unë të kisha ndërruar jetë. Poshtërimi nuk ngeli me aq, por po atë mbrëmje të largimit nga Ambasada, punëdhënësi më shkëputi numrin e telefomit të punës, pa më lënë kohë të njoftoja familjarët e mi, të cilët nuk ndodhen në Tiranë.*

E ndodhur në kushte të vështira ekonomike, për shkak se jetoj e vetme në Tiranë dhe familja ime nuk ka mundësi ekonomike të më mbështesë, u detyrova të pranoj ofertën e punëdhënësit për transferimin tek SGS me gjoja të njëjtin pozicion si supervizore sigurie, por rezultoi pozicioni i rojes tek dera dhe me pagë bruto 36.000 lekë, më pak nga paga e pozicionit të mëparshëm”.

Ankuesja vijon duke shpjeguar se, në kushtet kur dinjiteti i saj ishte nëpërkëmbur nga Ambasada, i është drejtuar me një letër shpjeguese Ministrisë së Punëve të Jashtme në Francë, dhe në mënyrë specifike Drejtorisë së Sigurisë Diplomatike, pra, eprorëve të Shefit të Sigurisë në Ambasadë, drejtori e cila kishte aprovuar pozicionin e saj si Asistente Sigurie, në vitin 2016.

Ankuesja ka pretenduar se, punëdhënësi, ICTS, në momentin që është informuar nga Ambasada lidhur me ankesën e saj drejtuar organeve të shtetit francez, e ka ndëshkuar me vërejtje, me argumentimin se ky veprim kishte vënë në vështirësi Shoqërinë në raport me Klientin (Ambasadën) dhe e paralajmëroi se nëse vazhdon ta ndjekë këtë çështje ai do përshkallëzonte masat ndaj saj.

Në vijim, vetëm një muaj nga emërimi i ankuses në pozicionin e ri të punës, pranë SGS Fushë Prezë, punëdhënësi ka zgjidhur në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës me të, për shkaqet e mëposhtme:

- Shoqëria ICTS ndodhej në pamundësi për të vijuar marrëdhënien kontraktore me shoqërinë SGS, në kushtet e përfundimit të afatit të kontratës më këtë subjekt dhe mosrinovimit të saj përtej datës 31.12.2020, për shkak të përfundimit të Kontratës Konkensionare të SGS me Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
- Referuar përcaktimeve të nenit 2.3 të Kontratës së Punës, përfundimi i kontratës me SGS, passjell automatikisht dhe ndërprerjen e marrëdhënies të punësimit të ankueses me ICTS.
- Shkak tjetër ishte edhe fakti që ankuesja si punëmarrëse nuk kishte marrë masa në kohë për rinovimin e licencës së SHPSF-së.

Lidhur me pretendimin e punëdhënësit për mosrinovimin e licencës së SHPSF-së, ankuesja është shprehur se, megjithëse kishte vënë në dijeni ICTS lidhur me faktin se ajo me datë 20.11.2020, kishte dorëzuar në komisariat, dokumentacionin përkatës për rinovimin e licencës, punëdhënësi me datë 01.01.2021 shkëputi marrëdhëniet e punës me të.

Ankuesja citon se: *“Duke u ndodhur në këtë situatë diskriminimi, e vetme përballë një përfaqësie të huaj ku asnjë komisariat nuk pranonte të merrte padinë time duke u justifikuar se çështja ka ndodhur në Ambasadë dhe nuk donin të përfshiheshin, po i drejtohem Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me qëllim ndjekjen e çështjes time në mënyrë që imazhi im të pastrohet”.*

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminim nga ana e Ambasadës Franceze/Tiranë dhe punëdhënësit, “ICTS Albania Integrated Services” sh.p.k, për shkaqet e pretenduara prej saj.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e*

Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

A. Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim në formën e shqetësimit nga ana e Ambasadës Franceze⁵ në Tiranë.

Në kontekst të legjitimitetit të ankimimit kundrejt subjekteve ndaj të cilëve ankuesja ka pretenduar diskriminimin, Komisioneri vëren se, Ambasada Franceze/Tiranë, përfshihet tek subjektet që gëzojnë imunitet kundrejt proceseve administrative që mund të ndërmerren ndaj tyre nga vendi pritës. Në këtë kuadër nuk mund t’i nënshtrohet hetimit administrativ pranë KMD-së.

Kuadri ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, lidhur me sa më sipër, parashikon si më poshtë:

Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se: “Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

a) Kushtetuta;

b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;

c) ligjet;

ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre”.

Neni 122 i Kushtetutës përcakton se:

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik, pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë

⁵ Z. Th. G, punonjës i Ambasadës Franceze/Tiranë, në detyrën e Shefit të Sigurisë Operacionale të Ambasadës.

anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

Konventa e Vjenës “Mbi Marrëdhëniet Diplomatike” (Konventa) ka hyrë në fuqi për Shqipërinë më 08.02.1998. Neni 31 i Konventës ka përcaktuar se:

“1. Agjenti diplomatik gëzon imunitetin e juridiksionit penal të Shtetit pritës. Ai gëzon gjithashtu imunitetin e juridiksionit të tij të civil dhe administrativ, përveç kur bëhet fjalë:

a) për një veprim real lidhur me një ndërtesë private që ndodhet në territorin e Shtetit pritës, përveç kur agjenti diplomatik e posedon atë për llogari të Shtetit akreditues për qëllimet e misionit.

b) për një veprim lidhur me një trashëgimi në të cilin agjenti diplomatik figuron si zbatues i testamentit, administrator, trashëgimtar ose legatar, si privat dhe jo në emër të Shtetit akreditues. c) për një veprim lidhur me një profesion të lirë ose me një aktivitet tregtar çfarëdo qoftë, të ushtruar nga agjenti diplomatik në Shtetin pritës jashtë funksioneve të tij zyrtare.

2. Agjenti diplomatik nuk është i detyruar të japë dëshminë e tij.

3. Asnjë masë zbatimi nuk mund të merret karshi agjentit diplomatik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat a), b) dhe c) të paragrafit të parë të këtij neni, dhe me kusht që zbatimi të kryhet pa cenuar paprekshmërinë e personit të tij ose të banesës së tij”.

Aktet ndërkombëtare të miratuara nga shteti shqiptar, të tilla si Karta e OKB-së dhe Konventa mbi Privilegjet dhe Imunitetet e Kombeve të Bashkuara, Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (e vitit 1961, hyrë në fuqi për Shqipërinë më 08.02.1998), Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore (1963), Konventa për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjensive të Specializuara dhe anekset e saj, si dhe marrëveshjet dy palëshe të ndryshme të lidhura me shtetit Shqiptar dhe shteteve të tjera, përcaktojnë rrethin e subjekteve që janë të përjashtuar nga juridiksioni territorial i brendshëm gjyqësor dhe administrativ dhe, si pasojë, nuk mund të jenë subjekte të padive, kërkimeve apo procedurave të ekzekutimit në vendin tonë. Përjashtimi nga juridiksioni territorial i vendit pritës, Shqipërisë, përfshin të gjitha funksionet zyrtare të këtyre subjekteve dhe është i paprekshëm⁶.

Marrëveshjet ndërkombëtare sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 116), kanë një status superior ndaj ligjeve. Ligji shqiptar dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku shteti shqiptar është palë njohin dhe pranojnë mungesën e juridiksionit të gjykatave shqiptare, për shkak të imunitetit që gëzon njëra prej palëve në mosmarrëveshje si subjekt i posaçëm parashikuar në një marrëveshje/konvente dy ose shumëpalëshe.

⁶ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 10.06.2011.

Bazuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, evidentohet se e drejta e aksesit në gjykatën kombëtare i'u nënshtrohet rregullimeve kufizuese për atë sa këto kufizime nuk reduktojnë aksesin e individit në gjykatat kombëtare në një mënyrë të tillë, apo në atë masë sa të dëmtojë thelbin e të drejtës. Dhënia e imunitetit palës së paditur në bazë të marrëveshjeve dypalëshe dhe legjislacionit në fuqi nuk mund të thuhet se tejkalon marzhin e vlerësimit që shtetit shqiptar i lejohet në kufizimin e aksesit të individit në gjykatë. Kjo bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ, sipas së cilës “... disa kufizime mbi aksesin (në gjykatë) duhet të konsiderohen si të qënësishme, si për shembull ato kufizime që përgjithësisht pranohen nga komuniteti i shteteve si pjesë e doktrinës së imunitetit shtetëror⁷”.

Në një rast të ngjashëm, për përcaktimin e juridiksionit ndërkombëtar të gjykatave shqiptare, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin njëhësues se, kur midis subjekteve që gëzojnë imunitet nga juridiksioni gjyqësor shqiptar, sipas Marrëveshjes Dypalëshe të lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës datë 10.06.1992, janë lidhur kontrata punësimi me punëmarrës shqiptarë, pavarësisht nga ligji i aplikueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, gjykatat shqiptare nuk kanë juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga këto marrëdhënie, përveç rasteve kur është pranuar juridiksioni i gjykatave shqiptare vullnetarisht⁸.

Anëtarët e përfaqësive diplomatike nuk janë nën juridiksionin gjyqësor shqiptar, vetëm nëse ata e pranojnë këtë me vullnetin e tyre. Ky përjashtim nga juridiksioni shqiptar është i parashikuar në nenin 39 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, ku sanksionohet juridiksioni ndaj përfaqësuesve diplomatik e konsullorë: “Anëtarët e përfaqësive diplomatike e konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare. Ekzistojnë rastet dhe kushtet e parashikuara nga Konventa e Vjenës “Mbi Marrëdhëniet Diplomatike””.

Sa më sipër, konform nenit 39 të Kodit të Procedurës Civile si dhe nenit 3 të Ligjit nr. 9105, datë 17.07.2003, “Për Aderimin e Shqipërisë në Konventën Për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjencive të Specializuara dhe Anekset e saj”, konstatohet dhe pranohet mungesa e juridiksionit gjyqësor. Gjykatat janë institucionet pranë të cilave mund të kundërshtohen aktet administrative të organeve të administratës shtetërore, ndër të cilat edhe vendimmarrja e KMD-së.

Po ashtu, neni 31/1 i Konventës së Vjenës “Mbi Marrëdhëniet Diplomatike”, ka përcaktuar qartë gëzimin e imunitetit të agentit diplomatik edhe përsa i takon juridiksionit administrativ.

⁷ MvElhinney kundër Irlandës [GC], nr.31253/96, § 37, ECHR 2001-XI; Manolescu dhe Dobrescu, (dec.), nr.60861/00, § 80, ECHR 2005-VI; Treska kundër Shqipërisë dhe Italisë (dec.), nr.26937/04, ECHR 2006; Vriani e të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë nr.35720/04 dhe 42832/06, § 44-47 ECHR 2009.

⁸ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 8, datë 10.06.2011

Në këtë kontekst, Komisioneri, konstaton mungesën e juridiksionit administrativ dhe kompetencës mbi subjektin e Ambasadës, për sa kohë edhe vetë gjykata, ka pranuar mungesën e juridiksionit gjyqësor lidhur me shqyrtimin e çështjeve me palë ambasadat e huaja në territorin e Shqipërisë.

B. Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim nga punëdhënësi, shoqëria “ICTS Albania Integrated Services” sh.p.k.

Pas shqyrtimit paraprak të dokumentacionit të sjellë pranë Komisionerit, si dhe bazuar në kërkesë-padinë e ankueses drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁹ (Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga znj. Z për diskriminim nga ana e punëdhënësit, ICTS, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor¹⁰.

Theksojmë se të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu i njëjti shkak që bëhet prezent në kërkesë padinë e paraqitur para Gjykatës, është pretenduar dhe tek Komisioneri.

Komisioneri konstaton se:

- Në objektin e kërkesë padisë, në pikën 1 të tij, ankuesja, *inter alia*, ka kërkuar: *“Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin me 12 muaj pagë, për shkak të zgjidhjes së marrëdhënies së punës pa shkaqe të arsyeshme dhe në kundërshtim me ligjin (neni 146, paragrafi 1, germa “c” dhe neni 32 i Kodit të Punës, si dhe nenet 3 nënparagrafi 13 dhe 14, 3/1, 7, 12 të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”)*.
- Tek baza ligjore e cituar, në pikën 2 të saj ka cituar specifikisht: *“Nenet 3 nënparagrafi 13 dhe 14, 3/1, 7, 12 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*.

Në parashtrimet e kërkesë padisë së bërë nga ankuesja pranë Gjykatës, ndër të tjera, në faqet 5-6 të saj, citohet se zgjidhja e marrëdhënieve të punës është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, dhe specifikisht duke nenet 3/13/14, 3/1, 12, 13, 15, të cilat parashikojnë se:

“Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.

⁹ Kërkesë padia është depozituar pranë Gjykatës me datë 02.04.2021.

¹⁰ Kërkesë padia e ankuesit ka si palë të

“Shqetësim seksual” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, verbale ose joverbale, e natyrës seksuale, e cila ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për të.

“Formë e rëndë diskriminimi” është çdo sjellje diskriminuese që është motivuar nga më shumë se një shkak, kur është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose kur ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën përbën formë të rëndë të diskriminimit.

“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me, trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës. Ndalohet çdo lloj shqetësimi, përfshirë edhe shqetësimin seksual, nga punëdhënësi përkundrejt një punëmarrësi ose një kërkuesi për punë ose midis punëmarrësve”.

“Punëdhënësi është i detyruar: të zbatojë, të mbrojë e të nxisë parimin e barazisë dhe të ndalimit të çdo lloj diskriminimi; të marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi, brenda një muaji nga marrja e dënjesisë; t’u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre. Punëdhënësi detyrohet të rrisë ndërgjegjësimin për këtë ligj edhe duke e afishuar atë në mjediset publike të vendit të punës, si dhe të mundësojë kuptimin e plotë të tij me mjetet e veta ose me ndihmën e subjekteve të specializuara”.

“Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit.

Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.

Punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës, si dhe të marrë shpjegime për vendimet e marra nga punëdhënësi, në përgjigje të ankesës së tij, menjëherë pas shqyrtimit.

Në rast se punëdhënësi nuk merr masa për të hetuar dhe për të zgjidhur ankesën për diskriminim, punëmarrësi që ka bërë ankesën ka të drejtë ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për aq kohë sa është e nevojshme për t’u mbrojtur nga diskriminimi. Punëmarrësi kthen pagën e marrë, sipas këtij neni, në rast se diskriminimi i pretenduar

nuk rezulton i vërtetuar me vendim të formës së prerë”.

Në përfundim të kërkesë padisë drejtuar Gjykatës, ankuesja ka kërkuar ndër të tjera, detyrimin e punëdhënësit ta dëmshpërblejë me 12 muaj pagë, bazuar në nenet 3 nënparagrafi 13, 14, 3/1, 7, 12 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Komisioneri, vlerëson se, juridiksioni gjyqësor është i ndarë nga ai administrativ, por aktet e këtij të fundit janë objekt kontrolli nga gjykata administrative, e cila vendos përfundimisht për çështjen. Në rastin e ankuesit, të njëjtat fakte, rrethana, parashtrime, janë bërë objekt shqyrtimi si në juridiksionin administrativ dhe atë gjyqësor.

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në nenin 33, pikën 7/4 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes“, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën nr. 73 Regj., datë 22.04.2021, të E. Z, përse i takon pretendimeve të saj kundrejt punëdhënësit/shoqërisë “ICTS Albania Integrated Servises” sh.p.k dhe deklaron pushimin e procedurës për shqyrtimin e saj.**

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.**

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në Kushtetutën e Shqipërisë, Konventën e Vjenës “Mbi Marrëdhëniet Diplomatike”, nenin 39 të Kodit të Procedurës Civile, nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 3 të ligjit nr. 9105, datë 17.07.2003, “Për Aderimin e Shqipërisë në Konventën Për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjencive të Specializuara dhe Anekset e saj”, si dhe referuar nenit 32, pika 1, germa a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 73 Regj., datë 22.04.2021, të paraqitur nga E. Z kundër Ambasadës Franceze/Tiranë, lidhur me pretendimin e diskriminimit në formën e shqetësimit, për shkak se është e papajtueshme me parashikimet ligjore të nenit 31, të Konventës së Vjenës “*Për Marrëdhëniet Diplomatike*”, nenit 39 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.
2. Të deklarojë pushimin e çështjes me nr. 73 Regj., datë 22.04.2021, të paraqitur nga E. Z kundër punëdhënësit, “ICTS Albania Integrated Services” sh.p.k , për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha: Punësim

Shkaku: Gjinia

Lloji i vendimit: Pushim shqyrtimi i çështjes